



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 45 Akti

Nr. 16 Vendimi

Tiranë më 03.05.2018

VENDIM

Trupa gjyquese e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, e përbërë nga:

Alma Faskaj (Vokopola)
Roland Ilia
Firdes Shuli

Kryesuese
Relator
Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore Znj. Ina Serjanaj, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, Z. Theo Jacobs, në Tiranë, më datën 30 prill 2018, ora 11:00 paradite dhe 3 maj 2018 në Pallatin e Kongreseve, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Fatjona Memçaj**, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, e cila kërkoi konfirmimin në detyrë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/ b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr.76/2016, datë 22.7.2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar”; **Ligji nr. 84/2016** “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; **Ligji nr. 44/2015** “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; **Ligji nr. 49/2015** “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” .

TRUPA GJYKUESE E KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, komisionerin Roland Ilia, dëgjoi subjektin e rivlerësimit, Znj. Fatjona Memçaj, vëzhguesin ndërkombëtar, pasi shqyrtoi në tërësinë e tij në seancë dëgjimore publike vlerësimin kalimtar ndaj subjektit Fatjona Memçaj, e cila kërkoi konfirmimin e saj në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

Subjekti i rivlerësimit, Znj. Fatjona Memçaj, ushtron detyrën e prokurores në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Tiranë dhe, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*.

Subjekti i rivlerësimit, duke qenë anëtare e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, në bazë të nenit 284 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, u është nënshtruar procedurave të rivlerësimit me përparësi, duke u shortuar si subjekt me shortin e hedhur në datën 30.11.2017, në përputhje me “Rregulloren për procedurat e zhvillimit të shortit” nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit. Relatori i çështjes u zgjodh me short komisioneri Roland Ilia.

Me vendimin e datës 12.12.2017, trupa gjyquese ka zgjedhur kryesuese për këtë çështje anëtares Alma Faskaj. Në respektim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupës gjyquese, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ nga relatori i çështjes. Vëzhgues ndërkombëtar për këtë subjekt rivlerësimi është caktuar Z. Theo Jackobs.

Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: 1) Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI); 2) Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) dhe 3) Grupi i Punës në Prokurorinë e Përgjithshme.

Këto raporte janë administruar nga relatori në fillim të hetimit administrativ.

ILDKPKI, pasi ka kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar¹, duke konkluduar se:

1. *Deklarimi është i saktë, në përputhje me ligjin;*
2. *Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
3. *Nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
4. *Nuk ka kryer deklaram të rremë;*
5. *Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarameve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, dhe ka dërguar një raport të arsyetuar², duke konkluduar mbi *“Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, Znj. Fatjona Memçaj.”*

Grupi i Punës në Prokurorinë e Përgjithshme ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të 5 dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, ka dërguar raport të hollësishëm dhe të arsyetuar³ mbi subjektin e rivlerësimit.

Në vijim, nga ana e relatorit të çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në nenin 14, pika 5, të ligjit nr. 84/2016. Në përfundim të hetimit administrativ, si dhe nga studimi i çështjes, është konkluduar në tërësi se:

“Nga vlerësimi në tërësi i pasurisë së subjektit të rivlerësimit nuk janë konstatuar elementë që mund të ngrënë dyshime për fshehje apo deklaram të rremë nga ana e subjektit të rivlerësimit. Deklarimet duken të sakta dhe në përputhje me ligjin.

Nga hetimi mbi pastërtinë e figurës, nuk u gjet asnjë element që të vërtetojë mbi përfshirje të mundshme të subjektit të rivlerësimit në veprime korruptive, për shkak të funksionit apo ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

Pasi u hetua raporti i Grupit të Punës në Prokurorinë e Përgjithshme dhe denoncimet, nuk u gjetën indicie apo elemente që mund të ngrinin dyshime për paaftësi profesionale apo cilësi që cenojnë figurën e prokurorit.

Trupa gjyquese, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me raportin dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, më datë 18.04.2018, vendosi përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit, Znj. Fatjona Memçaj, si dhe njoftimin e këtij subjekti për t’u njohur me materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni, si dhe rezultatet e hetimit, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Pocerave Administrative.

¹ Me shkresën me nr. ***, datë 13.11.2017, e përbërë nga 12 fletë, është dërguar raporti i ILDKPKI-së, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016.

² Me shkresën nr. *** prot., datë 31.10.2017, dërgohet raporti i DSIK-së për subjektin e rivlerësimit në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016.

³ Me shkresën nr. *** prot., datë 12.01.2018, dërgohet raporti i Grupit të Punës në Prokurorinë e Përgjithshme.

Më datë 20.04.2018, subjektit të rivlerësimit iu bë e njohur përbërja e trupës gjyquese, si dhe u lajmërua se ka të drejtë të paraqesë pretendime/sqarime shtesë apo të kërkojë marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e përfutura nga hetimi kryesisht të zhvilluar nga ana e Komisionit. Subjekti i rivlerësimit deklaroi se nuk kishte konflikt interesi me anëtarët e trupës.

QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

Znj. Fatjona Memçaj ka qenë bashkëpunuese gjatë gjithë procesit të rivlerësimit, duke u përgjigjur kur i është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Subjekti i rivlerësimit ka qenë korrekte dhe e gatshme për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Subjekti i rivlerësimit, Znj. Fatjona Memçaj, është prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Tiranë dhe, bazuar në nenin 179/b, nenet Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në ligjin nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit për këtë subjekt përfshiu: (1) vlerësimin e pasurisë, (2) kontrollin e figurës dhe (3) vlerësimin e aftësive profesionale.

Gjatë procedurës së rivlerësimit të subjektit janë administruar akte nga Ministria e Drejtësisë, Prokurorisa e Përgjithshme, Banka e Shqipërisë dhe banka të nivelit të dytë, zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, shoqëria “***” sh.p.k., Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, drejtoritë rajonale të tatimeve, Qendra Kombëtare e Biznesit, Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a., shoqërisë “Ujësjellës-Kanalizime Tiranë” sh.a.

I. VLERËSIMI I PASURISË

Mbledhja e informacioneve dhe provave për vlerësimin e pasurisë

Në bazë të ligjit organik nr. 84/2016, objekti i vlerësimit të pasurisë është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të kontrollit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat private për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij. Pas analizimit të raportit dhe dosjes së dërguar nga ILDKPKI-ja, relatori i çështjes ka kryer hetimin dhe vlerësimin e pavarur të të gjitha fakteve dhe rrethanave lidhur me vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, duke kërkuar informacion nga subjektet e së drejtës publike, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016.

1. Pasuria apartament banimi 2+1, me sipërfaqe 62 m², në Shkodër, me bashkëpronarë bashkëshortin e subjektit të rivlerësimit, Z. D. A., motrën e tij, Znj. A. A., dhe prindërit e

tyre, Z. A. A. dhe Znj. F. A., përfituar nga privatizimi. Këtë apartament ata e shesin kundrejt vlerës 1.900.000 (një milion e nëntëqind mijë) lekë.

Vjehri i subjektit të rivlerësimit, Z.A. A., porositi apartament banimi në kullën “***”, Tiranë, me sipërfaqe 96.00 m², kundrejt vlerës 27.800 (njëzet e shtatë mijë e tetëqind) dollarë⁴. Legalizimi dhe regjistrimi i këtij apartamenti është kryer në emër të Z. A. A. (babai i bashkëshortit) 50% dhe Z. D. A. (bashkëshorti) 50%.

Hetimi i kryer nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit⁵

Trupa gjyquese, mbështetur në analizën ekonomike të të ardhurave dhe shpenzimeve, vlerëson se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë pasur të ardhura të mjaftueshme për të blerë apartamentin me sip. 96 m².

Nga hetimi i kryer nga Komisionim, nuk ka dyshime mbi këtë pasuri. Përputhet deklarimi i subjektit me përgjigjet e ardhura nga organet shtetërore.

2. Prona apartament banimi, me sip. 83 m², në Shkodër.

Gjatë hetimit të kryer nga Komisioni⁶, rezultoi se sipas kartelës së pasurisë vol. ***, fq. ***, subjekti i rivlerësimit, Znj. Fatjona Memçaj, së bashku me prindërit e saj, Z. M. M. dhe Znj. B. M., janë bashkëpronarë të pasurisë me nr. ***, apartament me sipërfaqe 83 m², në rrugën “***”, lagjja “***”, në Shkodër. Kjo pasuri është regjistruar në ZVRPP Shkodër më 21.11.1995. Sipas dokumentacionit shoqërues, ky apartament është përfituar nga privatizimi pranë ndërmarrjes së banesave sipas ligjit “Mbi privatizimin e banesave shtetërore”, kundrejt vlerës 18.760 (tetëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë) lekë.

Subjekti i rivlerësimit, Znj. Fatjona Memçaj, nuk e ka deklaruar asnjëherë këtë pasuri ndër vite dhe as në Deklaratën “Vetting”.

Për këtë apartament, subjekti i rivlerësimit deklaroi se kjo pasuri është fituar nga prindërit, M. dhe B. M., si dhe motra e saj madhore në kohën e privatizimit të banesave shtetërore, L. M. (datëlindja 27 qershor 1970), bazuar në ligjin nr. 7652, datë 23.12.1992, “Për privatizimin e banesave shtetërore”. Referuar nenit 20 të këtij ligji dhe dispozitave të Kodit Civil, Znj. F. M. nuk ka mundur të jetë pjesëmarrëse në privatizimin e kësaj banese, pasi ka qenë nën 18 vjeç (datëlindja e subjektit të rivlerësimit është 30 nëntor 1976). Znj. Memçaj asnjëherë nuk ka pasur të drejtë pronësie mbi këtë apartament. Sipas subjektit të rivlerësimit, prindërit e saj, Z. M. dhe Znj. B. M., si dhe motra e saj, Znj. L. M., ia kanë shitur këtë apartament shtetasit D. B. Familja e subjektit të rivlerësimit nuk ka dijeni nëse kjo kontratë shitblerjeje është

⁴Shih në dosjen e ILDKPKI-së kontratën e sipërmarrjes, të datës 15.02.2003, lidhur mes Z. A. A. dhe “***” sh.p.k. Shuma për këtë apartament është krijuar nga shitja e apartamentit me nr. pasurie 6/38 në Shkodër, si dhe nga kursimet familjare ndër vite.

⁵Shih në dosjen e Komisionit shkresën e ZVRPP-së Tiranë nr. *** prot., datë 27.02.2018. Shkresën nr. K-1028/1 prot., datë 01.03.2018, të Ujësllës-Kanalizimeve Tiranë.

⁶Për më tepër shih në dosjen e Komisionit shkresat e ZVRPP-së Shkodër, nr. ***, datë 01.02.2018, si dhe nr. ***, datë 17.01.2018.

regjistruar pranë Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Shkodër, e drejtë dhe detyrim ky që i takon blerësit, Z. D. B.⁷

Përpara këtyre shpjegimeve, Komisioni i ridërgoi shkresë ZVRPP-së Shkodër, nga përgjigjja e së cilës rezultoi se *përputhet deklarimi i subjektit me përgjigjet e ardhura nga organet shtetërore*⁸.

3. Automjet “Audi 2”, viti i prodhimit 2002, targuar ***, në zotërim 50% të subjektit të rivlerësimit, Znj. Fatjona Memçaj, dhe 50% të bashkëshortit, Z. D. A., e fituar me kontratën e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 05.10.2015, çmimi 2500 (dymijë e pesëqind euro).

Nga hetimi i kryer nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, nuk ka dyshime mbi këtë pasuri (makinë). Përputhet deklarimi i subjektit me verifikimin e kryer.

4. Motor “Vespa”, në zotërim 50% të subjektit të rivlerësimit, Znj. Fatjona Memçaj, dhe 50% të bashkëshortit, Z. D. A., e fituar me kontratën e shitblerjes nr. *** rep., *** kol., datë 10 prill 2014, 40.000 (dyzetëmijë lekë) lekë.

Nga hetimi i kryer nga Komisioni, nuk ka dyshime mbi këtë mjet.

5. Kursime ndër vite 14.500 (katërbëdhjetë mijë e pesëqind) euro

- a. llogari kursimi në BKT, në emër të bashkëshortit, 6.500 (gjashtëmijë e pesëqind) euro;
- b. diferenca prej 8.000 (tetëmijë) eurosh gjendje në *cash*.

Përputhet gjendja e llogarive rrjedhëse të subjektit të rivlerësimit dhe të bashkëshortit të saj me deklarimin e tyre.

6. Gjatë shqyrtimit të dosjes së ardhur nga ILDKPKI-ja konstatohet se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, Z. D. A., në datat 01.01.2009 dhe 01.01.2013 ka lidhur kontrata me shoqërinë “***” sh.p.k., me objekt ofrimin e shërbimit të dhënies së konsulencës ligjore⁹ me afat 5-vjeçar. Në këto kontrata nuk është deklaruar masa e shpërblimit.

Bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka deklaruar gjithashtu të ardhura nga kjo veprimtari në vlerën 1.676.830 lekë, nga të cilat, me transaksione bankare dhe me mandat arkëtimi, bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit i kanë kaluar 1.380.740 lekë.

⁷ Pyetësori i datës 19.03.2018 dhe dokumentet bashkëlidhur.

⁸ Shih në dosjen e Komisionit shkresën nr. *** datë 06.04.2018 të ZVRPP-së Shkodër, sipas së cilës informacioni i dërguar në bazë të kartelës së pasurisë vol. ***, fq. ***, është në bazë të afishimit të ZK ***, afishim i cili rezultoi në gabuar pasi Znj. Fatjona Memçaj nuk rezultoi të ketë qenë bashkëpronare e kësaj pasurie. Subjekti i rivlerësimit s'ka qenë bashkëpronare e pasurisë me nr. ***, apartament me sipërfaqe 83 m², në rrugën “***”, lagja “***”, në Shkodër, si dhe kjo pasuri është regjistruar në favor të Z. D. B., në bazë të kontratës së shitblerjes rep. *** dhe nr. kol. ***, datë 20.08.1999.

⁹ Shih në dosjen e ILDKPKI-së kontratat për shërbim konsulence të datës 01.01.2009, si dhe të datës 01.01.2013.

Duke qenë se masa e shpërblimit (çmimi) konsiderohet element thelbësor i kontratës, është pyetur subjekti i rivlerësimit se mbi ç'bazë është përcaktuar pagesa për shërbimet e konsulencës, të kryera nga Z. D. A., si dhe i është nisur shkresë edhe shoqërisë “***” sh.p.k., për të sqaruar këtë situatë.

Subjekti i rivlerësimit, Znj. Fatjona Memçaj, sqaron se pagesa nuk ka qenë mbi një tarifë fikse po variabël. Ajo ka qenë në bazë të kontributit të dhënë mbi shërbime të ndryshme që ka kryer për këtë shoqëri, në varësi të punës së kryer prej tij, dhe asaj çfarë shoqëria ka përfituar nga kontributi i tij. Kjo marrëdhënie është konfirmuar edhe nga “***” sh.p.k.¹⁰.

Vlera është element esencial i kontratës. Gjatë analizës financiare janë marr parasysh pagesat e bëra me transaksione bankare dhe me mandat pagese.

7. Automjeti tip “Volkswagen Golf”, me targë ***, gjatë hetimit rezultoi se ka mospërputhje mes deklaramit të subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë dhe praktikës së ardhur nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor.

Pas verifikimit të bërë nga Komisioni rezultoi se përputhet deklarami i subjektit me verifikimin e kryer.

8. Në lidhje me pasurinë e luajtshme, automjetin tip “Smart”, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit e ka blerë automjetin në fjalë në vlerën 1000 euro, ndërkohë sipas deklaratës së pasurisë së subjektit në 2009-n automjeti është blerë 2000 euro.

Me pyetësorin e datës 19.03.2018, subjekti i rivlerësimit, Znj. Fatjona Memçaj, lidhur me këtë deklaram të pasaktë shpjegon se deklarata e vitit 2009 pasqyron vlerën e vërtetë të paguar shitësit, ku përfshihet 1000 euro vlera e mjetit, si dhe të gjitha shpenzimet për riparime, pasi mjeti nuk ishte në gjendje të mire teknike.

Shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit ishin bindëse dhe të mjaftueshme.

9. Në deklaratën fillestare subjekti deklaron pronësinë mbi një automjet “Volkswagen 19E”, me targa ***, me vlerë 250.000 lekë. Në deklaratën e vitit 2004 këtë automjet e deklaron me vlerë 350.000 lekë.

Subjekti i rivlerësimit, në lidhje me këtë pasaktësi shpjegon se vlera e saktë është pikërisht ajo e deklaruar nga ana e saj në deklaratën fillestare, pra 250.000 lekë. Vlera tjetër e përmendur ka qenë një gabim njerëzor nga ana e subjektit të rivlerësimit.

Shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit duken bindëse dhe të mjaftueshme.

10. Në lidhje me një tjetër pasuri të luajtshme, automjetin “Volkswagen Vento”, nga shqyrtimi i dosjes rezulton se në deklaratën e vitit 2004 subjekti deklaron blerjen e “Volkswagen Vento”, me targa ***, në vlerën 220.000 lekë. Në deklaratën e vitit 2006,

¹⁰Për më tepër shih në dosjen e Komisionit shkresën nr. ***, datë 21.03.2018.

deklaron shitje të automjetit tip “Volkswagen Passat” në 350.000 lekë. Ka një pasaktësi në deklaram për sa i përket tipit të “Volkswagen”-it nga “Passat” në “Vento”.

Paqartësitë sipas subjektit të rivlerësimit vijnë si rezultat i faktit të mosnjohjes së markave të makinave.

Komisionit vlerëson se shpjegimet e subjektit të rivlerësimit janë shterruese.

11. Nga Regjistri Noterial i Republikës së Shqipërisë rezultoi se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, Z. D. A., ka kryer disa veprime (akte noteriale) të cilat, pas verifikimit, nuk rezultuan si akte me probleme.

Rekomandimi për vlerësimin e pasurisë

Sa më sipër, pavarësisht nga raporti i hollësishëm i dërguar nga ILDKPKI-ja, për të bërë një vlerësim të pasurisë së subjektit të rivlerësimit sa më objektiv dhe të paanshëm, është kryer hetim administrativ nga ana e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Nga vlerësimi i provave të marra gjatë këtij hetimi administrativ, ka rezultuar se nuk ka dyshime mbi pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe llogaritë e subjektit të rivlerësimit, përfshi dhe personave të lidhur me të. Po kështu, në të gjitha rastet e hetuara përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjet e ardhura nga institucionet shtetërore.

Nga analiza financiare rezulton se për periudhën 2003-2016 subjekti, me të ardhurat e fituara nga pagat e saj¹¹ dhe të bashkëshortit¹², ka pasur burime të mjaftueshme për blerjen e pasurive të deklaruara, si dhe për shpenzimet e kryera.

Në dritën e gjetjeve të mësipërme dhe nga vlerësimi në tërësi i pasurisë së subjektit të rivlerësimit, vërehet se nuk janë konstatuar elemente që mund të ngrënë dyshime për fshehje apo deklarim të rremë nga ana e subjektit të rivlerësimit. Deklarimet e subjektit të rivlerësimit janë të mjaftueshme. Pas verifikimit ato rezultojnë të sakta dhe në përputhje me ligjin.

II. KONTROLLI I FIGURËS

Mbledhja e informacioneve dhe provave mbi pastërtinë e figurës

¹¹Të ardhurat nga pagat si prokurore pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë; si drejtore juridike pranë institucionit të Presidencës së Republikës, nëntor 2007-dhjetor 2012; si drejtore e kabinetit të Prokurorit të Përgjithshëm për periudhën janar-qershor 2013; si prokurore pranë Prokurorisë së Apelit 2013-dhjetor 2016. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka siguruar të ardhura nga mësimdhënia në Fakultetin e Shkencave Sociale, në Universitetin Beder, si dhe mësimdhënia në Shkollën e Magjistraturës.

¹²Të ardhurat, ndër të tjera, nga pagat si punonjës pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për periudhën 01.08.2000- 12.04.2016; paga si ndihmës ligjor pranë Prokurorisë së Përgjithshme, të ardhurat nga konsulenca në shoqërinë “***” sh.p.k. Gjithashtu, ka krijuar të ardhura nga shitja e mjetit “Mercedes-Benz Vaneo”, në vlerën 2.500 (dy mijë e pesëqind) euro me kontratën e shitblerjes nr. rep ***, nr. kol ***, datë 20.06.2016.

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, duke dërguar raport për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ku ka konkluduar mbi *përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, Znj. Fatjona Memçaj.*

Për vlerësimin e figurës së subjektit të rivlerësimit, Znj. Fatjona Memçaj, është kryer një proces i mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi, duke bërë disa verifikime mbi pastërtinë e figurës, duke hetuar mbi përfshirjen e subjektit të rivlerësimit drejtpërdrejt ose indirekt në veprime të dyshimta, mbi përfshirjen e subjektit të rivlerësimit në kontakte me persona të papërshtatshëm (anëtarë të organizatave kriminale, persona të dënuar penalisht apo persona të dyshuar për kryerjen e veprave penale).

Rekomandimi për vlerësimin e kontrollit të figurës

Nga hetimi administrativ, nuk u gjet asnjë element që të vërtetojë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

Për subjektin e rivlerësimit konstatohet se është në kushtet e përshtatshme për vazhdimin e detyrës si prokurore.

III. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

Mbledhja e informacioneve dhe provave mbi vlerësimin e aftësive profesionale

Raporti për analizën e aftësive profesionale kryer nga Grupi i Punës në Prokurorinë e Përgjithshme, është bazuar te:

- Formulari i vetëdeklarimit, te 3 (tri) dokumentet ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, si dhe te të dhënat e dokumentet e tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit;
- 5 (pesë) dosjet penale, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor;
- Të dhënat nga burimet arkivore të sektorit të burimeve njerëzore në Prokurorinë e Përgjithshme.

Nga kjo analizë konstatohet:

1. Aftësitë profesionale

a) Njohuritë ligjore

Subjekti i rivlerësimit, prokurorja Fatjona Memçaj, ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Në 3 dokumentet ligjore të paraqitura prej saj dhe në 5 dosjet e vëzhguara, është konstatuar se ajo identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye të qarta për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Në disa raste, e analizon normën penale dhe procedurale penale të zbatueshme, duke e lidhur përmbajtjen e saj me akte të tjera ligjore dhe nënligjore, apo me praktikën gjyqësore, kryesisht atë unifikuese të Gjykatës së Lartë, të Gjykatës Kushtetuese.

Në vlerësimet e punës së subjektit të rivlerësimit, prokurores Fatjona Memçaj, për vitet 2014, 2015 dhe 2016, të bëra nga Prokurori i Përgjithshëm, rezulton se:

- Për vitin 2014 – subjekti Fatjona Memçaj është vlerësuar “shumë mirë” për aftësitë profesionale të treguara prej saj, bazuar në të njëjtin vlerësim të bërë nga drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.
- Për vitin 2015 – subjekti Fatjona Memçaj është vlerësuar “shumë mirë” për aftësitë profesionale të treguara prej saj, bazuar në të njëjtin vlerësim të bërë nga drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.
- Për vitin 2016 – subjekti Fatjona Memçaj është vlerësuar “shumë mirë” për aftësitë profesionale të treguara prej saj, bazuar në të njëjtin vlerësim të bërë nga drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.

b. Arsyetimi ligjor

Subjekti i rivlerësimit, Znj. Fatjona Memçaj, ka aftësi në arsyetim ligjor. Aktet e arsyetuara prej saj janë të qarta dhe të kuptueshme. Aktet e përpiluara prej saj konceptohen me tri pjesë. Përgjithësisht, përmbajtja e aktit është gjithëpërfshirëse dhe u jepet përgjigje çështjeve që parashtrihen për zgjidhje. Në tekstet e akteve ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur prokurorja. Në nxjerrjen e konkluzioneve i kushton rëndësi analizës së normës ligjore. Niveli i arsyetimit të akteve të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor.

2. Aftësitë organizative

a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Subjekti i rivlerësimit Fatjona Memçaj, në periudhën e rivlerësimit 08.10.2013 – 08.10.2016 ka kryer detyrën e prokurores në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.

Prokurorja Fatjona Memçaj, në periudhën e rivlerësimit, ka trajtuar gjithsej 1132 çështje penale. Ajo ka përballuar ngarkesën e punës, me efikasitet.

Subjekti i rivlerësimit, konstatohet se në respektim të afateve procedurale ka paraqitur qëndrimin e saj para gjykatës dhe para drejtuesit.

Në analizë të të dhënave të mësipërme, konstatohet se subjekti i rivlerësimit prokurorja Fatjona Memçaj është efçente dhe efektive. Në efektivitetin dhe efçencën e veprimtarisë së saj nuk ka ndikuar ngarkesa sasiore, e cila ka qenë e lartë. Në këtë drejtim duhet evidentuar se koha është një aspekt i rëndësishëm i procesit të rregullt ligjor.

b) Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore

Subjekti i rivlerësimit, prokurorja Fatjona Memçaj, merr pjesë në gjykim, si palë, duke përfaqësuar Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Tiranë. Konstatohet se është e aftë profesionalisht në këtë pjesmarrje dhe për qëndrimin që mban për çështjet në gjykim.

c) Aftësia për të administruar dosjet

Nga vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short, konstatohet se dosjet janë të administruara rregullisht, kanë listën e inventarit, materialet janë të vendosura në rend kronologjik përgjithësisht, na njohin me faktin penal, me qëndrimin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë dhe të Apelit, disponimin e Gjykatave.

3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

a) Etika në punë

Në periudhën Shtator 2013 e aktualisht ushtron detyrën e Prokurores në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Tiranë Tiranë.

Gjithashtu subjekti i rivlerësimit, konstatohet se ka ushtruar edhe profesionin e pedagoges (pedagoge e jashtme) në Univeristetin e Tiranës dhe në Shkollën e Lartë Hëna e Plotë – Beder. Prokurorja Fatjona Memçaj, ka qenë edhe lehtësuese në Programin e Formimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës për vitet 2013 – 2016.

Nga aktet e përzgjedhura nga vetë subjekti si dhe nga dosjet e hedhura në short, ka rezultuar se gjuha e përdorur nga subjekti i rivlerësimit në përpilimin e akteve, është në përputhje me etikën profesionale të prokurorit.

b) Integriteti

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit prokurorja Fatjona Memçaj dhe nga 5 dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me ndikimin e saj ndaj çdo joshje apo presioni të jashtëm.

c) Paanësia

Nga 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga 5 dosjet e vëzhguara, nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit prokurorja Fatjona Memçaj. Në asnjë prej 5 dosjeve të vëzhguara, nuk ka të dhëna mbi ndonjë shkak paanësie të dokumentuar. Nga ana tjetër, asnjë prej 3 dokumenteve ligjore dhe 5 dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave. Në 3 dokumentet ligjore dhe në aktet e 5 dosjeve të vëzhguara nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elementë të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

Nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit prokurorja Fatjona Memçaj të ketë cenuar të drejtat e palëve dhe të viktimave.

4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

a) Aftësia e komunikimit

Në 5 dosjet gjyqësore të vëzhguara, në format letër dhe në 3 dokumentat e dorëzuara prej saj, gjuha e përdorur në akte është normale, komunikimi në përputhje me etikën e prokurorit dhe i qartë.

b) Aftësia për të bashkëpunuar

Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit, prokurores Fatjona Memçaj, për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën e Prokurorisë, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta.

c) Gatishmëria për t'u angazhuar

Subjekti i rivlerësimit, prokurorja Fatjona Memçaj, ka marrë titullin “Jurist” në vitin 1999 në Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi”. Prokurorja Fatjona Memçaj ka deklaruar ndjekjen e studimeve pranë Shkollës së Magjistraturës në Republikën e Shqipërisë në periudhën 1999 – 2002, diplomuar me titullin “Magjistrat prokuror”.

Ajo ka deklaruar specializim në “Master of Laws”, Universiteti i Londrës Lindore, Mbretëria e Bashkuar, në periudhën 2007 – 2008. Subjekti i rivlerësimit, prokurorja Fatjona Memçaj, ka deklaruar se është candidate për gradën “Doktor”, në Middlesex, Universiteti i Londrës, Mbretëri e Bashkuar, filluar në vitin 2010. Ky fakt dokumentohet me një fotokopje të një letre (komunikimi) të drejtuar prokurores Fatjona Memçaj nga Universiteti Middlesex Londër, më datë 22 janar 2014. Bashkëlidhur është dorëzuar një fotokopje letre (komunikimi) e Universitetit Middlesex Londër, drejtuar prokurores Fatjona Memçaj, në të cilën pasqyrohet kalimi i saj nga “Mphi” në “PhD”.

Subjekti i rivlerësimit, prokurorja Fatjona Memçaj, i nënshtrohet programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Megjithatë, në periudhën e rivlerësimit, ajo deklaroi se është angazhuar në 2 aktivitete profesionale (seminare), ndërkohë që rezultoi se është angazhuar në rolin e lehtësueses pranë Shkollës së Magjistraturës në kuadrin e Programit të Trajnimit Vazhdues. Gjithashtu, Znj. Memçaj është angazhuar edhe në aktivitete të tjera trajnuese jashtë Shkollës së Magjistraturës.

Vlerësimi i aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, Znj. Fatjona Memçaj, bazuar në ankesat e subjekteve denoncues si më poshtë:

1. Në denoncimin e shtetasit V.Ç;
2. Në denoncimin e shtetasit M. B.;

Denoncimi 1.

Me anë të denoncimit¹³, shtetasi V.Ç. denoncon subjektin e rivlerësimit, Znj. Fatjona Memçaj, për korrupsion. Denoncimit të tij, shtetasi V. Ç. i ka bashkëlidhur kallëzimin penal të datës 16.07.2017 kundër 3 gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe kundër prokurores së Apelit, Znj. Fatjona Memçaj.

Sipas denoncuesit, subjekti i rivlerësimit ka shpërdoruar detyrën, pasi kur denoncuesi në seancën gjyqësore të datës 13.7.2017, para Gjykatës së Apelit Tiranë, ka kërkuar përjashtimin e trupit gjykues, Znj. Memçaj ka kërkuar rrëzimin e kërkesës për përjashtimin e gjithë trupit gjykues, në vend që prokurorja Memçaj të kërkonte pezullimin e shqyrtimit gjyqësor e të shtyhej seanca, pasi me ligj prokurori ushtron ndjekje penale dhe shtetasi V.Ç. po akuzonte në seancë gjithë trupin gjykues për korrupsion nëpërmjet shpërdorimit të detyrës.

Për sa më sipër, i është kërkuar informacion Prokurorisë së Përgjithshme¹⁴, e cila bashkëlidh përgjigjen¹⁵ që, për sa i përket kallëzimit të mësipërm, është dërguar kërkesa për pushimin e çështjes më datë 19.2.2018 në Gjykatën e Shkallës së Parë Durrës.

Denoncimi 2.

Shtetasi bjellorus, M.B., denoncon subjektin e rivlerësimit, Znj. Fatjona Memçaj, për proces të parregullt ligjor.

Sipas denoncuesit, me vendimin nr. *******, datë 26.10.2016, në mungesë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë ka caktuar masën e sigurimit “arrest me burg” për veprën penale të vjedhjes me mashtrim më shumë se një herë.

Në datën 10.06.2017, shtetasi M.B. arrestohet nga autoritetet e shtetit indonezian, duke u mbajtur deri në datën 24.08.2017 dhe më pas sillet në Shqipëri, duke u izoluar në I EVP Fushë-Krujë, ku ndodhet aktualisht.

Me vendimin nr. *******, datë 28.05.2017, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë ka vendosur: Caktimin si masë sigurimi personal atë të “ndalimit të daljes jashtë shtetit”.

Me vendimin nr. 1108, datë 03.10.2017, Gjykata e Apelit Tiranë, trupi gjykues i përbërë nga H.D., E. Ll. dhe E.T. dhe me pjesëmarrjen e prokurores Fatjona Memçaj, ka vendosur

¹³ Nr. ******* prot., datë 26.12.2017.

¹⁴Për më tepër shih shkresën nr. 2433 prot., datë 12.3.2018, drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme.

¹⁵Për më tepër shih në dosje shkresën e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës nr. ******* prot., datë 23.02.2018.

“Ndryshimin e vendimit nr. ***, datë 25.08.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, duke caktuar si masë sigurimi “arrestin me burg”.

Në marrjen e këtij vendimi, Gjykata e Apelit, së pari nuk ka verifikuar faktin nëse kishte kompetencë tokësore, pasi vepra penale për të cilën denoncuesi akuzohej kishte ndodhur në juridiksionin tokësor të rrethit Durrës dhe, nga ana e saj, duhet të vendosej mospranimi i apelit të prokurorit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, pasi ai nuk kishte tagër procedural për të bërë ankim në lidhje me procedimin penal.

Për më tepër, sipas denoncuesit, gjykimi i çështjes është bërë pa pjesëmarrjen e denoncuesit, edhe pse njihej adresa e tij.

Me vendimin nr. ***, datë 113.10.2017, që ka marrë formë të prerë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë ka vendosur shpalljen e moskompetencës tokësore dhe dërgimin e akteve pranë Gjykatës kompetente, që është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës”.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. ***, datë 11.12.2017, vendosi masën e sigurimit “arresti me burg”.

Me vendimin e datës 29.12.2017, Gjykata e Apelit Durrës ka lënë në fuqi vendimin nr. ***, datë 13.12.2017.

Gjykata e Apelit Tiranë, me shkresën nr. 2360/2, datë 9.3.2018, përcjell vendimin nr. ***, datë 03.10.2017.

Pas shqyrtimit të denoncimit të paraqitur nga shtetasi M.B., nuk ka indicie për të provuar pretendimin e denoncuesit.

Rekomandimi për vlerësimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit

Vlerësimi i aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit u bazua në gjetjet e mësipërme dhe pas një analize të bërë në përputhje me ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe kreun II të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

a) Lidhur me aftësitë profesionale

Subjekti i rivlerësimit, prokurorja Fatjona Memçaj, ka respektuar parashikimet ligjore dhe ato nënligjore. Aktet janë përgatitur prej saj, në respektim të dispozitave procedurale penale.

Në rastin e çështjeve me natyrë procedurale, përdor metodat e interpretimit për të nxjerrë thelbin e institutit procedural që është në diskutim. Ndërsa në rastin kur problematika lidhet me zbatimin e ligjit material, i kushton rëndësi çdo elementi të veprës penale për të konkluduar në kualifikimin e faktit penal sipas normës penale. Identifikon rastet kur norma ligjore plotësohet nga akte nënligjore. Sipas shkresës së Prokurorisë së Përgjithshme, nr. ***, datë 13.02.2018, për subjektin e rivlerësimit nuk ka masë disiplinore.

b) Lidhur me aftësinë organizative

Nga analiza e 5 (pesë) çështjeve të përzgjedhura në short, rezultoi se qëndrimi i saj, është mbajtur brenda afateve, sipas kërkesave të ligjit procedural penal.

Lidhur me kohën mesatare të arsyetimit të vendimeve konstatohet se nga mënyra se si është organizuar dhe funksionon Prokuroria, mbështetur në parashikimet ligjore procedurale penale, nuk ka ekzistuar ndonjë afat, brenda të cilit prokurorja të detyrohej të arsyetonte aktet

e saj. Subjekti i rivlerësimit konstatohet se, në respektim të afateve procedurale, ka paraqitur qëndrimin e saj para gjykatës dhe para drejtuesit.

c) Lidhur me etikën dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale

Subjekti i rivlerësimit, nisur nga rezultati i ankesave për këtë subjekt, verifikimi i tyre për periudhën e rivlerësimit, ka treguar angazhim dhe etikë në punë. Gjuha e përdorur nga subjekti i rivlerësimit në përpilimin e akteve është në përputhje me etikën profesionale të prokurorit.

Nga shqyrtimi i dosjes për këtë subjekt nuk kanë rezultuar të dhëna në lidhje me ndikimin apo presion të jashtëm. Për subjektin e rivlerësimit janë paraqitur 2 denoncime në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, të cilat nuk paraqesin indicie për veprime të kryera që cenojnë integritetin apo përbëjnë gjetje për paanësinë e saj gjatë ushtrimit të detyrës.

d) Lidhur me aftësitë personale dhe angazhimin profesional

Lidhur me aftësitë personale dhe angazhimin profesional rezulton se subjekti i rivlerësimit ka aftësi komunikimi dhe ka shprehur gatishmëri për t'u angazhuar në aktivitete profesionale.

Subjekti i rivlerësimit, prokurorja Fatjona Memçaj, i nënshtrohet programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Megjithatë, në periudhën e rivlerësimit, ajo deklaroi se është angazhuar në 2 aktivitete profesionale (seminare) ndërkohë që rezultoi se është angazhuar në rolin e lehtësueses pranë Shkollës së Magjistraturës, në kuadrin e Programit të Trajnimit Vazhdues. Gjithashtu, kjo prokurore është angazhuar edhe në aktivitete të tjera trajnuese jashtë Shkollës së Magjistraturës.

Për sa më sipër, pas hetimit të raportit të Grupit të Punës në Prokurorinë e Përgjithshme dhe denoncimeve, nuk u gjet asnjë indicie apo element që mund të ngrejë dyshime për paaftësi profesionale apo cilësi që cenojnë figurën e prokurores, Znj. Fatjona Memçaj.

SEANCA DËGJIMORE

Duke qenë se subjekti i rivlerësimit u njoh me rezultatet e hetimit administrativ të kryer nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit në datën 25.04.2018, trupa gjykuese, në prani të përfaqësuesit të vëzhguesve ndërkombëtarë, Z. Theo Jacobs, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit, Znj. Fatjona Memçaj, në seancë dëgjimore në datën 30.04.2018, ora 11:00 paradite, në Sallën e Konferencave, në pallatin e Kongreseve në Tiranë si hapi i fundit i procedurës së rivlerësimit. Znj. Fatjona Memçaj është njoftuar nëpërmjet komunikimit elektronik me *e-mail*, në datën 25.04.2018, për të cilin edhe ka komunikuar marrjen e dijenit dhe nuk ka pasur pretendime apo kërkesa të tjera shtesë.

Në seancën dëgjimore të datës 30 prill 2018, subjekti i rivlerësimit u paraqiti dhe u mbrojtë personalisht. Znj. Memçaj nuk paraqiti pretendime të reja shtesë, deklaroi se ishte dakord me rezultatet e hetimit dhe kërkoi rikonfirmimin në detyrë.

VLERËSIMI I ÇËSHTJES NGA TRUPA GJYKUESE E KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT

Trupa gjykuese e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtuara nga subjekti i rivlerësimit, konstaton se:

Së pari, trupa gjykuese mori në analizë kontrollin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, raportin e hollësishëm dhe të arsyetuar të ILDKPKI-së, konkluzionet e nxjerra pas hetimit, informacionet e kërkuara nga subjektet e së drejtës publike, sipas nenit 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016 dhe pretendimeve dhe provave të parashtuara nga subjekti i rivlerësimit.

Në procesin e rivlerësimit të subjektit përfshihet kontrolli i pasurisë, referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33 të ligjit nr. 84/2016. Sipas nenit D të Aneksit të Kushtetutës, subjekti i rivlerësimit dorëzon një deklaratë të re dhe të detajuar të pasurisë në përputhje me ligjin. ILDKPKI-ja kontrollon deklaratën e pasurisë dhe i dorëzon Komisionit një raport për ligjshmërinë e pasurive, si dhe për saktësinë e deklaramit.

Referuar nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të kontrollit Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së përgatit një raport të hollësishëm e të arsyetuar dhe, sipas rastit, konstaton se: a) deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin, me burimet e ligjshme financiare dhe që nuk gjendet në situatë konflikti interesi; b) ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë; është kryer fshehje e pasurisë; është kryer deklarim i rremë; subjekti gjendet në situatën e konfliktit të interesit.

Neni 33 i ligjit, ndër të tjera, parashikon se Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së, për qëllimet e rivlerësimit, mund të kërkojë nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave ose Ministrisë së Drejtësisë dokumentet për pasuritë në pronësi të subjekteve të rivlerësimit dhe personave të lidhur me ta, dokumentet që përdoren jashtë shtetit nga subjektet e rivlerësimit dhe personat e lidhur me ta, ose të dhënat financiare mbi çdo transaksion financiar brenda ose jashtë vendit në përputhje me ligjin “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit” të subjekteve të rivlerësimit dhe personave të lidhur me ta. Këto dokumente ose informacione mund të përdoren në cilësinë e provave përpara Komisionit ose Kolegjit të Apelimit.

Vetë Kushtetuta i ka njohur ILDKPKI-së kompetencën për realizimin e procedurës së kontrollit të deklaratës dhe përgatitjen e raportit të hollësishëm në lidhje me ligjshmërinë e pasurive, saktësinë dhe plotësinë e deklaramit. Në lidhje me vlerësimin e pasurisë, kushtetutëbërësi ka përcaktuar qartësisht organin që do ta kryejë procedurën e kontrollit të deklaratës dhe kompetencat e këtij organi, të cilat janë specifikuar më tej në ligjin nr. 84/2016. Edhe pse ligji ka parashikuar në mënyrë më të detajuar kompetencat e ILDKPKI-së dhe rolin e saj konkret në këtë proces, nuk rezulton që ato bien ndesh me kompetencën kushtetuese të organeve të rivlerësimit dhe as e cenon në thelb atë¹⁶.

¹⁶ Vendim i Gjykatës Kushtetuese Nr. 2/2017

Hetimi administrativ i thelluar i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit konsistoi në verifikimin e vërtetësisë së deklaratave në lidhje me gjendjen pasurore, burimet e krijimit, të ardhurat, shpenzimet, fshehje të pasurisë, deklaram të rremë apo konfliktin e interesit, për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur me të.

Ky hetim është përqendruar, mbi të gjitha, te pasuritë e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, Znj. Fatjona Memçaj.

Së dyti, trupa gjyquese mori në analizë kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, raportin e arsyetuar të DSIK-së mbi pastërtinë figurës së subjektit të rivlerësimit.

Referuar nenit 35/2 të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja menjëherë ka filluar procedurën e kontrollit të figurës së subjektit të rivlerësimit, Znj. Fatjona Memçaj, e cila ka plotësuar formularin përkatës.

DSIK-ja, pasi ka kryer procedurën e kontrollit të figurës së subjektit, sipas parashikimeve të neneve 34 deri në nenin 39 të ligjit nr. 84/2016 dhe ka përfunduar kontrollin për figurën e subjektit të rivlerësimit, ka dërguar raportin përfundimtar, sipas të cilit ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të prokurores Fatjona Memçaj.

Komisioni, pasi ushtroi të drejtën e kontrollit të pastërtisë të figurës së subjektit të rivlerësimit, konstatoi se nuk u gjet asnjë element që të vërtetojë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

Së treti, trupa gjyquese mori në analizë vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, raportin e hollësishëm dhe të arsyetuar të Grupit të Punës në Prokurorinë e Përgjithshme, konkluzionet e nxjerra pas hetimit të denoncimeve.

Në përfundim të kësaj analize, nuk u gjet asnjë indicie apo element që mund të ngrëjë dyshime për paaftësi profesionale apo cilësi që cenojnë figurën e prokurores, Znj. Fatjona Memçaj.

PËR KËTO ARSYE,

Trupa gjyquese e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar dhe në bazë të nenit 58, pika 1, germa “a”, si dhe të nenit 59, pika 1, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pasi konstatoi se subjekti ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, një nivel të besueshëm të kontrollit të figurës dhe një nivel të lartë të vlerësimit të aftësive profesionale,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, Znj. Fatjona Memçaj, me funksion prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.

2. Ky vendim i arsyetuar u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

ANËTARËT E TRUPËS GJYKUESE

Alma FASKAJ¹
Kryesues

Roland ILIA
Relator
(firma)

Firdes SHULI
Anëtare
(firma)

Sekretare gjyqësore
Ina SERJANAJ
(firma)

U shpall në Tiranë, më 3.5.2018

¹ Komisionere Alma Faskaj është në pamundësi objektive për të firmosur.